

VENDIM
Nr. 730, datë 2.9.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 429, DATË 12.9.2002, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E
DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHITESAVE
TË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 6, e vendimit nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se dyfishi i pensionit social dhe as më i lartë se katërfishi i tij.

Kufiri maksimal i shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror të jetë deri në katërfishin e pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.”.

2. Efektet financiare, nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2015, llogariten në shumën 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë dhe do të përballohen nga fondi i buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama